



MITROVICA

KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D.

Rruga e Liqenit p.n. – 40000 Mitrovicë

Data: 24.09.25 Nr.: 01-2055

POLITIKA E PRIVATËSISË

1. Hyrje

Kompania Rajonale e Ujësjiellësit 'Mitrovica' Sh.A. (KRU Mitrovica Sh.A.), me seli në Mitrovicë dhe me faqen zyrtare www.kru-mitrovica.com është e përkushtuar në mbrojtjen e të dhënave personale të konsumatorëve, punonjësve dhe vizitorëve. Kjo politikë është hartuar në pajtim me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, dhe synon transparencë e mbrojtje të plotë të privatësisë.

2. Përpunuesi i të dhënave personale

Përpunuesi i të dhënave është KRU Mitrovica Sh.A., me seli në: Rr, Liqenit Suhodoll, Pa.nr, 40000 Mitrovicë, Kosovë.

3. Kategoritë e të dhënave që mblidhen

- Të dhënat identifikuese: emër, mbiemër, numri personal, numri i kontratës;
- Të dhënat e kontaktit: adresa, telefoni, email-i;
- Të dhënat e shërbimit: lokacioni i objektit, shpenzimi i ujit, leximet e matësit;
- Të dhënat financiare: historiku i faturimit dhe pagesave;
- Të dhëna teknike: IP adresa, cookies, logjet e faqes së internetit;
- CCTV: video incizime nga hapësirat e sigurisë së kompanisë.

4. Qëllimet e përpunimit të të dhënave

- Ofrimi i shërbimeve të ujësjiellësit dhe kanalizimit;
- Faturimi dhe inkasimi i pagesave;
- Trajtimi i ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve;
- Përmirësimi i shërbimeve dhe mirëmbajtja e rrjetit;
- Përmbushja e detyrimeve ligjore dhe kontraktuale;
- Siguria e ambienteve të kompanisë përmes CCTV.

5. Bazat ligjore të përpunimit

Përpunimi i të dhënave personale nga KRU Mitrovica Sh.A. bëhet mbi këto baza ligjore:

- Pëlqimi i subjektit të të dhënave;
- Përmbushja e kontratës për ofrimin e shërbimeve;
- Përmbushja e obligimeve ligjore (Ligji Nr. 06/L-082 dhe ligjet sektoriale);
- Interesi legjitim për ofrimin e shërbimeve dhe sigurinë e rrjetit.

6. Marrësit e të dhënave

Të dhënat personale mund të ndahen me:

- Autoritetet publike sipas ligjit;
- Përpunuesit e autorizuar (p.sh., kompanitë e IT-së, shërbimet bankare, ofruesit e SMS/email);
- Vetëm në rastet kur kërkohet nga ligji ose është e nevojshme për ofrimin e shërbimit.

7. Ruajtja dhe siguria e të dhënave

KRU Mitrovica Sh.A. ruan të dhënat personale për aq kohë sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin janë mbledhur ose sa kërkohet me ligj. Masat teknike dhe organizative sigurojnë mbrojtje ndaj qasjes së paautorizuar, humbjes apo publikimit të paqëllimshëm.

8. Të drejtat e subjekteve të të dhënave

Subjektet e të dhënave kanë të drejtë të kërkojnë:

- Qasje në të dhënat e tyre personale;
- Korrigjim ose përditësim të të dhënave;
- Fshirje të të dhënave kur është e ligjshme;
- Kufizim të përpunimit;
- Të kundërshtojnë përpunimin;
- Transferueshmërinë e të dhënave;
- Ankesë pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

9. Ndryshimet në politikë

KRU Mitrovica Sh.A. mund të përditësojë këtë politikë privatësie. Ndryshimet do të publikohen në faqen www.kru-mitrovica.com dhe do të hyjnë në fuqi nga momenti i publikimit.

10. Zyrtari për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

KRU Mitrovica Sh.A. ka emëruar Zyrtar për Mbrojtjen e të Dhënave Personale:

Emri: Mentor Sejdiu

Email: info@kru-mitrovica.com

Tel: 0800 900 70 Thirrjet pa pagesë (08:00-16:00) Hëne-Premte

+383 46 915 645 Qendra e Thirrjeve (08:00-16:00)

11. Kontakt

Për çdo pyetje ose kërkesë lidhur me këtë politikë, mund të kontaktoni:

E drejta e ankimimit - Në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, çdo person fizik që beson se i është shkelur e drejta për mbrojtjen e të dhënave

personale, mund të paraqesë ankesë në Kompania Rajonale e Ujësjetllësit 'Mitrovica' Sh.A.në e-mail adresën: info@kru-mitrovica.com, pastaj pranë Agjencisë për informim dhe Privatësi me adresë: Rr. Zejnel Salihu - Nr.22, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës. (Web; <https://aip.rks-gov.net/>).

Për çdo pyetje ose kërkesë lidhur me këtë politikë, mund të kontaktoni:

Kompania Rajonale e Ujësjetllësit 'Mitrovica' Sh.A.

Adresa: Rr. Mbretëresha Teutë, nr. 163, 40000 Mitrovicë, Kosovë

Tel: +383 (0)28 530 546

Email: info@kru-mitrovica.com

Web: www.kru-mitrovica.com


Bashkim Kurti
Kryeshef Ekzekutiv